



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

DREJTIMI MËSIMOR “VETERINARI”

Janar, 2015

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Veterinari**”, me strukturë 4 bllok, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Veterinari”, Nivelit III (klasa e 10-të, 11-të, 12-të dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Veterinari**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “Veterinari”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Anatomi dhe Fiziologji , kl.10 dhe kl. 11.
2. Mikrobiologji veterinarë”, kl. 11 dhe kl. 12.
3. Kirurgjia veterinarë”, kl. 11.
4. Propiodeutikë”, kl. 11 dhe kl. 13.
5. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12.
6. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.
7. Riprodhimi i kafshëve, kl. 11, kl. 12 dhe kl. 13.
8. Farmakologji , kl. 12.
9. Parazitologji”, kl. 12 dhe kl. 13.
10. Kontrolli blegtoral”, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Mikrobiologji veterinarë 3	58	18
2	Patologji	20	6
3	Kirurgjia veterinarë 2	36	12
4	Propiodeutikë 3	36	12
5	Bazat e sipërmarrjes	19	6
6	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
7	Riprodhimi i kafshëve 5	70	22
8	Farmakologji 1	3	1
9	Parazitologji 3	37	12
10	Kontroll blegtoral 1	19	6
	TOTALI	312	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a. **“Mikrobiologji veterinarë”, kl.11 dhe kl.12:** (58 orë)
- Shfaqja e sëmundjeve infektive. 8 orë
 - Burimet e infeksionit. 4 orë
 - Qëndresa e organizmit ndaj infeksionit. 10 orë
 - Sëmundjet infektive të përgjithshme virale. 5 orë
 - Sëmundjet infektive të përgjithshme bakteriale. 7 orë
 - Sëmundjet infektive të përgjithshme zoonoza. 8 orë
 - Sëmundjet infektive të kafshëve të reja. 6 orë
 - Sëmundjet infektive të kafshëve të shoqërimin. 10 orë
- b. **“Patologji”, kl.11:** (20 orë)
- Njohuri të përgjithshme mbi sëmundjen 4 orë
 - Proceset patologjike regresive 3 orë
 - Proceset progresive në organizëm 4 orë
 - Çrregullimet lokale të qarkullimit të gjakut dhe të limfës 5 orë
 - Pezmatimi 3 orë
 - Çrregullimet termike në organizëm 1 orë
- c. **“Kirurgjia veterinarë”, kl.11:** (36 orë)
- Fiksimi i kafshëve. 8 orë
 - Injektimet dhe veglat kirurgjikale. 10 orë
 - Elementet e operacionit kirurgjikal. 8 orë
 - Dëmtimet traumatike të hapura. 5 orë
 - Dëmtimet traumatike të mbyllura. 5 orë
- d. **“Propiodeutikë”, kl.11 dhe kl.13:** (36 orë)
- Mënyrat e përgjithshme të diagnostikimit. 4 orë
 - Kontrolli i përgjithshëm i kafshës. 6 orë
 - Kontrolli i veçantë i kafshës së sëmurë. 8 orë
 - Kontrolli i aparatit të frymëmarrjes. 8 orë
 - Kontrolli i aparatit kardiovaskular. 4 orë
 - Kontrolli i aparatit urinor. 3 orë
 - Kontrolli i sistemit nervor. 3 orë
- e. **“Bazat e sipërmarrjes”, kl.12:** (19 orë)
- Menaxhimi i informacionit. 4 orë
 - Menaxhimi i marketingut. 5 orë
 - Tregu dhe sjellja konsumatore. 5 orë
 - Legjislacioni i punës. 5 orë

f.	“Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13:	(14 orë)
	• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor.	3 orë
	• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
	• Zhvillimet demografike dhe mjedisi.	4 orë
	• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet.	4 orë
g.	“Riprodhimi i kafshëve”, kl. 11, kl.12 dhe kl.13:	(70 orë)
	• Pjekuria seksuale dhe truporë.	6 orë
	• Cikli seksual.	10 orë
	• Ndërzimi dhe pllenimi i kafshëve.	10 orë
	• Mbarsmëria.	10 orë
	• Pjelljet te kafshët bujqësorë.	10 orë
	• Patologjitë e barrës.	8 orë
	• Patologjitë e kafshës pas pjelljes.	9 orë
	• Inseminimi artificial.	7 orë
h.	“Farmakologji”, kl.12:	(3 orë)
	• Bashkëveprimi midis barit dhe organizmit.	3 orë
i.	“Parazitologji”, kl.12 dhe kl.13:	(37 orë)
	• Njohuri të përgjithshme mbi Parazitologjinë.	4 orë
	• Helmitologjia.	8 orë
	• Trematodologjia.	6 orë
	• Njohuri për cestodozat.	2 orë
	• Njohuri mbi nematodët.	2 orë
	• Askaridiozat dhe oksiuozat.	7 orë
	• Zgjedhet e kafshëve.	8 orë
j.	“Kontrolli blegtoral”, kl.13:	(19 orë)
	• Përbërja dhe vlerësimi i mishit.	3 orë
	• Ekspertiza e mishit dhe produkteve të tij.	10 orë
	• Ekspertiza e qumështit, peshkut dhe vezëve.	6 orë